

VENDIM
Nr. 36, datë 28.7.2015

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN “SHQIPËRIA DIXHITALE”
DHE SHPALLJEN E THIRRJES PËR NDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN
“SHQIPËRIA DIXHITALE”, SHTYLLA II, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte për programin “Shqipëria dixhitale”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe institucionet e organizatat për zhvillim, agjencitë zbatuese e zhvillimore, qendrore e vendore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në “Fletoren zyrtare”, duhet të paraqesin në sekretariatën teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të projektit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të projektit.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e projektit deri në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi.

5. Shpalljen e thirrjes për financim të projekteve të programit “Shqipëria dixhitale”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015. Kjo thirrje për aplikim orientohet në drejtimet prioritare, si më poshtë vijon:

- Programi: “Shqipëria dixhitale” (inovacion dhe teknologji e informacionit dhe komunikimit);

- Nënprogrami 1: Rritja e aksesit dhe e përdorimit nga publiku, në nivel rajonal dhe kombëtar, të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që ofrohen nga pushteti qendror apo vendor nëpërmjet E-Shërbimeve fikse apo mobile.

- Nënprogrami 2: Përmirësimi i jetës së qytetarëve nëpërmjet zhvillimit teknologjik të qyteteve dhe rajoneve. (Qytetet inteligjente)

6. Aplikimi për financimin e projekteve në fushën e inovacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sipas pikës 5, të këtij vendimi, bëhet sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur. Institucionet aplikuese janë njësitë e qeverisjes qendrore, vendore e partneritetet rajonale, si dhe organizatat për zhvillim, agjencitë zhvillimore. Aplikimet për projektet dërgohen sipas formatit model të përdorur për aplikim.

7. Shqyrtimi për financim bëhet për projektet e aplikuara, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Procedura e vlerësimit kryhet në sekretariatën përkatës teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, si dhe në Sekretariatën e Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas kritereve të përcaktuara.

8. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim nga FZHR 2015, programi “Shqipëria dixhitale”

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Financimi për vitin 2015 (në lekë)	Financimi për vitin 2016 (në lekë)
1	Agjencia e Prokurimit Publik	Riinxhinierim dhe shtim funksionalitetesh/shërbimesh në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re.	166,128,200	83,064,100	83,064,100
2	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Implementimi i shërbimeve online të Ministrisë së Punëve të Jashtme	56,337,316	28,168,658	28,168,658
TOTALI			222,465,516	111,232,758	111,232,758

Shënim.

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të projektit (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike).

2. “Vlera e financimit për vitin 2015” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.

3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2016.

SHTOJCA I

KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projektaplikime për projekte në fushën e inovacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit
Jo më vonë se data 25 shtator 2015	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi	Dërgimi i projektideve sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi (shtojca IV) nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Nëpërmjet e-mail në adresë: sekretariati@inovacioni.gov.al 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike)
Për një periudhë 10-ditore, pas botimit në Fletoren Zyrtare	Sekretariati teknik (Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike)	Njofton aplikuesit për projektidetë të cilat janë kualifikuar për t'u paraqitur si projekte të plota për financim.
Për një periudhë 20-ditore, pas marrjes së njoftimit të kualifikimit të projektidesë nga sekretariati teknik.	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi.	Dërgimi e aplikimeve nga aplikuesit sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi (shtojca II) së bashku me termat e referencës të miratuara paraprakisht nga AKSHI, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike); 2. Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
6 (gjashtë) ditë nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik (Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike)	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas shkronjës "A", të shtojcës III.
	Sekretariati teknik (Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike)	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës teknik dhe financiar.
3 (tri) ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi i përputhshmërisë me strategjitë përkatëse kombëtare sipas shkronjës "B", të shtojcës III.
	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve
2 (dy) ditë nga përfundimi i vlerësimit nga Sekretariati i Përgjithshëm	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrje në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja e financimit për projekte të inovacionit dhe TIK, si pjesë e FZHR-së.

Shënim. Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kritereve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik për projektet në fushën e inovacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, i ngritur pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

2. Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kritereve të përcaktuara në shkronjën "A" të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.

3. Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në shkronjën "B", të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.

SHTOJCA II

FORMATI I APLIKIMIT

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes qendrore ose vendore, autoritetet dhe agjencitë zhvillimore, institucionet e pavarura etj.
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Lloji/sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është programi ku bën pjesë projekti “Shqipëria dixhitale”
Nënspektori i projektit (*)	Të përcaktohet nënspektori i projektit (komponentët e programit të investimit në TIK)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: 1. Përshkrimi i gjendjes aktuale; 2. Objektivat funksionale dhe qëllimi strategjik; 3. Zgjidhja teknologjike; 4. Grupet e interesit; 5. Logjistika dhe koha (vlerësimi i koston, burimet etj.); 6. Komunikimi me sistemet e tjera qeveritare ose lokale; 7. Risku i realizimit të projektit.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepen grupet e interesit dhe përfitues të qartë që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Përfitimi të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi. Në rastin kur projekti është në funksion të shërbimeve për publikun të theksohen qartë shërbimet sipas listës së 344 shërbimeve ose të tjera të reja. Në rastin kur projekti është në funksion të mirëmbajtjes të burimeve të të ardhurave apo shpenzimeve të nxirren qartë përfitimet (p.sh. nëse do të implementohet ky projekt do të kemi 20% shkurtim të fondit)
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti, renditimi projektet sipas prioritetit/ nevojës për ndërhyrje (numri 1, për shumë prioritar; numri 2, për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike, nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga NJQ-të ose NJV-të apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore	
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në modernizimin e qeverisjes apo të shërbimeve (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e shtetit apo të shërbimeve.	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e shtetit apo të shërbimeve.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin e projektit.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal, kombëtar(*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e strategjisë kombëtare; - pjesë e zbatimit të akteve ligjore apo nënligjore; - pjesë e planeve të investimeve qendrore ku përfshihen dhe përfitojnë - edhe njësitë e qeverisjes vendore; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç’lloj plani). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti.

Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik; - preventivin; - argumentimin teknik; - përllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit.
------------------------	---

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

Shënim. Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

Me shkresë zyrtare (postë), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit pranë sekretariatit teknik (Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike)

2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariatit teknik (MSHIAP) dhe listën e projekteve të aplikuara. Projektet e aplikuara duhet të jenë të renditura sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues.

SHTOJCA III KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE (SHTYLLA 2 E FINANCIMIT: "SHQIPËRIA DIXHITALE")

A. Kriteret e vlerësimit teknik dhe financiar

Këto kriteret përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi maksimalisht me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik për projektet e arsimit, i ngritur pranë ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS).

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Përmes këtij kriteri vlerësohet nëse, projekti që do të financohet, ka:

- Projekt teknik, të detajuar saktë dhe qartë (harta, gentplane etj.); dhe
- Preventiv dhe kostim të projektit, të përpiluar dhe vlerësuar saktë nga institucioni aplikues, sipas çmimeve të referencës në buletinet e përditësuara etj.

Sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS), ngarkohet të kryejë rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial, të paraqitura nga institucioni aplikues, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të përgatisë raportin e vlerësimit financiar të tyre dhe rekomandimet përkatëse.

Vlerësimi teknik e financiar do të bëhet me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 25 pikë.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elementë të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike (të jepet informacion edhe në lidhje me pronësinë e tokës, në rastet e ndërtimit të objekteve të reja).

Vlerësimi i nivelit të ulët të riskut vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

3. Niveli i ndikimit të projektit:

a) Në shërbimet bazë, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin dhe zhvillim social të zonës në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimit dhe zhvillimit të aftësive. Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë, nga 0 deri në 5 pikë.

b) Në nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në infrastrukturën arsimore, duke adresuar edhe shkakun. Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë, nga 0 deri në 5 pikë.

Totali i pikëve të vlerësimit për nivelin e ndikimit shkon nga 0 deri në 10 pikë.

4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi do të bëhet me pikë, nga 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të nxënësve/mësuesve/banorëve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë. Vlerësimi do të bëhet me pikë, nga 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

6. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i ndikimit në mjedis, analiza kosto - përfitim etj. Vlerësimi do të bëhet me pikë, nga 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

7. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues etj. Vlerësimi do të bëhet me pikë, nga 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

B. Kriteret e vlerësimit të përputhshmërisë

Përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, ndërvendor apo rajonal, duke vlerësuar një projekt me, maksimalisht, 30 pikë, sipas kriterëve në vijim:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonar/kombëtar. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.

2. Shkalla e ndikimit në zhvillimin social në qendrat kryesore të qarkut, ose sa projekti i investimit ndikon në konsolidimin e strukturës arsimore dhe sociale në zonën ku ndodhet projekti. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.

SHTOJCA IV

FORMATI I APLIKIMIT, PROJEKTIDE

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes qendrore ose vendore, autoritetet dhe agjencitë zhvillimore, institucionet e pavarura etj.
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Lloji/sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është sektori ku bën pjesë projekti (Shqipëria dixhitale)
Nënspektori i projektit (*)	Të përcaktohet nënspektori i projektit (komponentët e programit të investimit në TIK)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Cila është nevoja për këtë projekt (*)	Jepni një përshkrim të shkurtër të situatës ekzistuese dhe shtysat kryesore për këtë projekt ide, për shembull, problemin që ju duhet të zgjidhni apo rrethanat që ju detyrojnë për të realizuar produktin e këtij projekti. Nevojat kryesore që shtynë përpara këtë projekt mund të kenë natyrë 'strategjike' ose 'operacionale', shembuj tipikë janë: Nuk arrihen nivelet e kërkuar të shërbimit: - Rritje e kostove operacionale; - Ndryshimi në kërkesat e funksioneve apo detyrave; - Ndryshimet në legjislacion/rregulloret; - Ndryshime si pasojë e një programi të qeverisë/shërbime të reja ose të zgjeruara. Duhet të përshkruani situatën aktuale dhe, kur është e mundur, disa tregues të qartë të niveleve të performancës aktuale (p.sh., numri i aplikimeve të përpunuara në ditë, numri i kërkesave që u përgjigjeni, normat e gabimit etj.), për të siguruar si fillim një bazë për matjen e përmirësimeve në të ardhmen.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Tregoni se çfarë ka për qëllim të përmbushë ky projekt. - Cilat janë rezultatet apo përfitimet e pritura? Cilat janë rezultatet e pritura në fund të projektit? Objektivat duhet të jenë specifike, të arritshme, të rëndësishme dhe të orientuar mirë në kohë. - Objektivat e specifikuar këtu do të formojnë bazën e vlerësimit të suksesit të përgjithshëm të projektit, sigurisht nëse ai do të miratohet.
Grupet e Interesit dhe Numri i përfituesve (*)	Listoni të gjitha grupet kryesore të palëve të interesuara, të cilat mund të preken (pozitivisht ose negativisht) nga projekti. Këtu përfshijn grupet e tilla si: - Stafi i Ministrisë/Institucionit (p.sh., stafi front-line, back-office, menaxhimi etj.); - Ministrinë e tjera të qeverisë; - Qytetarët; - Bizneset; - Organizatat joqeveritare dhe grupe të veçanta të interesit; - Njësitë e qeverisjes vendore; - Partnerët e sektorit (p.sh., klinikat shëndetësore, shkollat apo rajonet e policisë).
Zgjidhja që propozohet (*)	Fushëveprimi i zgjidhjes së propozuar Duhet të siguroheni që të ketë një përshkrim të përgjithshëm të asaj që projekti do të ofrojë, duke përfshirë (por jo i kufizuar) si më poshtë: - Cilat funksione, procese, programe, shërbime dhe sisteme përfshijn projekt; - Cilat procese do të rimodelohen, rregullohen ndryshe ose ndryshohen; - Burime dhe palë të tjera të cilat do të përfshihen në punën për këtë projekt (objekte të veçanta, ndërfaqe, ministritë/institucionet, pushteti vendor apo grupe të tjera të përfshira); - Jepni arsye të qartë për zgjedhjen që keni bërë duke rekomanduar këtë zgjidhje; - Përshkruani ndonjë nga praktikën më të mira apo kërkime të tjera që keni kryer në mbështetje të zgjidhjes së propozuar. Teknologjia: Identifikoni dhe përshkruani implikimet teknike që lidhen me zgjidhjen e propozuar. - Është prezent apo do të ndërtohet ndonjë sistem i ri? - Do të zëvendësojë ndonjë nga sistemet ekzistuese? Nëse po, kur? - Do të propozojë ndryshime në ndërfaqe apo zgjidhje teknike për lidhjen me sistemet e tjera.
Risqet dhe qëndrueshmëria e projektit	Të përshkruhet në mënyrë të qartë cilat janë risqet për ekzekutimin e projektit si dhe të

(*)	përkruhet qëndrueshmëria e projektit.
Vlerësimet për burimet, koston dhe kohën (*)	Plani i punës dhe afatet kohore: - Përfshini një përshkrim bazë të fushave kryesore të punës, duke përmendur edhe piketa të nivelit të lartë së bashku me datat e synuara. - Afatet kohore për kur do të fillojë dhe parashikimi për fundin e projektit. Vlerësimi i koston: Këtu përfshihen vlerësimet fillestare për angazhimet financiare (p.sh. shpenzimet e pritura për realizimin e projektit). - Burimet e informacioneve që janë marre parasysh për llogaritjen e preventivave apo vlerësimit të kostove (p.sh.: proceset e brendshme, ekspertë të fushave si dhe të menaxhimit, shpenzimet për testimin dhe trajnimin, menaxhimin e brendshëm të projektit etj.). - Burimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit që janë përgjegjës për të ndihmuar institucionin që të identifikojë mundësitë për të adresuar nevojat e tyre funksionale, dhe për të siguruar vlerësimin e koston së lidhur me përdorimin e teknologjisë për të informatizuar procesin (p.sh.: hardware, software, nevojat për zhvillim etj.). Burimet: - Vlerësimet paraprake për burimet njerëzore dhe sasia e punës së nevojshme për të përfunduar projektin. - Duhet të përfshihen të dyja kategoritë e burimeve si të brendshme e të jashtme, dhe vëmendje t'u kushtohet burimeve për menaxhimin e projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes qendrore apo vendore	
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi
Kostoja totale e projektit (*)	
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e shtetit apo të shërbimeve.	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e shtetit apo të shërbimeve.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal, kombëtar(*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e strategjisë kombëtare; - pjesë e zbatimit të akteve ligjore apo nënligjore; - pjesë e planeve të investimeve qendrore ku përfshihen dhe përfitojnë edhe njësitë e - qeverisjes vendore; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'lloj plani). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti.